

L I G J
Nr.7508, datë 7.8.1991

PËR POLICINË USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Policia ushtarake është organ ekzekutiv, që shtrihet në njësinë e bashkuar operative dhe merret me sigurimin e ruajtjen e pjesetarëve të forcave të armatosua e të pasurisë ushtarake, me mbajtjen e rregullit e të disiplinës në garnizonet ushtarake, në mjedise të tjera dhe në rrjetin e transportit qytetar e ndërqytetar si dhe me zbulimin e atyre që kryejnë vepra penale ushtarake.

Neni 2

Policia ushtarake përbëhet nga nënrepartet luftarake me efektiv të zgjedhur dhe me përgatitje speciale, në përputhje me detyrat që kryhen.

Neni 3

Efektivi i forcave të policisë ushtarake pajiset me armatimin, mjetet luftarake dhe materialet e domosdoshme. Uniforma, mjetet e transportit dhe ato luftarake mbajnë ngjyrë e shenja dalluese të përcaktuara, të ndryshme nga forcat e tjera. Pajisjet profesionale janë njëloj me ato të forcave të ruajtjes së rendit.

Neni 4

Policia ushtarake kryen këto detyra :

1. Mban rregull ushtarak e disiplinë në garnizonet ushtarake, në qytete, në qendra të banuara, në stacione e rrjetin e transportit, në poligone e fushime gjatë stërvitjeve, në shkolla e institucione ushtarake, si dhe në vende që përcaktohen me urdhër nga komanda përkatëse. Kontrollon lëvizjet e ushtarakëve jashtë kazermave, paraqitjen e jashtme dhe sjelljet e tyre në mjedise publike.

2. Ndjek dhe kap ushtarakët që mungojnë në repart pa arsye. Merret, sipas rekomandimit të organeve të mobilizimit ushtarak, me kërkimin e qytetarëve që i shmangen shërbimit ushtarak.

3. Organizon dhe siguron transportin ushtarak, kontrollon trafikun e automjeteve ushtarake dhe i shoqëron kur dalin nga kazerma për stërvitje ose për ndonjë veprimtari tjetër.

4. Mbron njerëzit e pasurinë ushtarake dhe zbulon ata që kryejnë ndaj tyre vepra penale ushtarake. Ruan dhe shoqëron personat ushtarakë me rëndësi.

5. Siguron ruajtjen, në raste festash dhe në raste të tjera të veçanta të reparteve dhe të institucioneve ushtarake më të rëndësishme.

6. Në bashkëpunim me organet e informacionit e të edukimit në ushtri parandalon, ruan dhe nuk lejon që ushtaraku të merret me përdorimin e drogës, me shitjen e armatimit, të municionit dhe të materialeve të tjera ushtarake.

7. Në rast lufte organizon dhe ruan vendet për qëndrimin e robërve të luftës.

Neni 5

Në rast se ushtarakët e forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, shkelin rregullin dhe disiplinën ushtarake, policia ushtarake sipas rastit bën këshillim, merr letërnjoftimin dhe dokumentet e tjera identifikuese, i shoqëron ata në vendet e caktuara, informon komandat përkatëse, si dhe ndërhyr duke përdorur forcën fizike. Ndërhyrja bëhet kur rregulli e disiplina nuk janë vendosur me gjithë masat e marra dhe në rast kundërshtimi nga ushtaraket. Në objektet ushtarake ndërhyhet vetëm me urdhër dhe autorizim.

Kur shkelja përbën vepër penale, policia ushtarake bën kallezimin në organet kompetente.

Neni 6

Forcat e policisë ushtarake përdorin armët e zjarrit sipas dispozitave të ligjit përkatës.

Neni 7

Policia ushtarake përdor dhunën e shkallëzuar kundër ushtarakëve dhe civilëve që e pengojnë atë për të kryer detyrën.

Shtetasit që pengojnë kryerjen e detyrave nga policia ushtarake, shoqërohet dhe dërgohet në organet e ruajtjes së rendit publik.

Neni 8

Policia ushtarake për kryerjen e detyrave, bashkëpunon ngushtë me organet e pushtetit dhe ato të ruajtjes së rendit publik.

Neni 9

Ministria e Mbrojtjes të hartojë rregullore të veçantë me detyra të hollesishme për policinë ushtarake si dhe strukturën organizative, uniformen dhe shenjat dalluese të saj.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.20, datë 13.8.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia